



SH.LUJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"



Universiteti Marin Barleti
Nr. prot. 2818 Tiranë 13.11.2019

Universiteti Ismail Qemali
Nr. prot. 1558 Tiranë 14.11.2019

Marrëveshje Bashkëpunimi

Ndërmjet:

Universitetit Marin Barleti

dhe

Universiteti Ismail Qemali

duke mbajtur parasysh se:

- institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;
- është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;
- dy universitetet synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;
- ato synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë,

palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të mësimdhënies; kërkimit shkencor; qytetit inteligjent; industrive kreative; ekonomia e dijes; e ardhmja digjitale; turizmi dhe industritë ndërlidhur; zinxhiri i vlerës ushqimore; zhvillimi i qëndrueshëm, i integruar dhe gjithëpërfshirës; shteti i të drejtës dhe zbatimi ligjit; sporti, shëndeti dhe edukimi etj.



Neni 1 **Qëllimi dhe Objekti**

1. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke midis palëve në fushat si vijon:
 - a. Transferimi i dijes dhe teknologjisë përmes programeve të përbashkëta dhe aktiviteteve kërkimore të aplikuara;
 - b. Shkëmbim të stafit akademik, personelit teknik dhe studentësh;
 - c. Aplikim të përbashkët në projekte dhe programe të përbashkëta lokale dhe ndërkombëtare;
 - d. Praktika mësimore në kuadër të procesit akademik dhe specializimeve;
 - e. Organizim aktiviteteve dhe eventesh, konferencash e tryezash të përbashkëta për shkëmbim idesh, por dhe sensibilizimin publik rreth temave me interes të përbashkët;
 - f. Organizim të seminareve, konferencave, publikimeve dhe aktivitete të ndryshme shkencore;
 - g. Përdorim të ambienteve respektivisht për praktika, laboratore, seminare, konferenca etj;
 - h. Promovim të palëve në kuadër të aktiviteteve të secilit partner.

Neni 2 **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 2 (dy) vjet nga data e nënshkrimit.
2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 2 (dy) vjeçar.

Neni 3 **Informacion mbi palët**

1. *Universiteti MARIN BARLETI* (në vijim Marin Barleti) është një universitet jo publik, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkurruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitë, bazuar në praktikën e vlerat më të mira ndërkombëtare, me programe shumë disiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.



2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë u hap në 10 Tetor 1994 me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 105, datë 28.02.1994. Fillimisht mësimi filloi si Universiteti Teknologjik i Vlorës "Ismail Qemali", me tri fakultete — Fakulteti i Tregtisë, Fakulteti i Inxhinierisë Detare dhe Fakulteti i Infermierisë. Gjatë periudhës 20-vjeçare të ekzistencës së vet, Universiteti Ismail Qemali i Vlorës ka bërë përpjekje serioze e të vazhdueshme për rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore. Universiteti i Vlorës numëron 17 departamente me mbi 10.000 (dhjetë mijë) studentë në tre nivelet e studimit. Deri tani janë diplomuar mbi 4000 studentë.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Universiteti Marin Barleti:*

- a. Marin Barleti angazhohet në ofrimin e mjediseve për trajnime, uorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- b. Marin Barleti angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- c. Marin Barleti angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojnë kontribut Universitetit "Ismail Qemali", me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
- d. Personi i kontaktit do të jetë: Znj. Esmeralda Hasani.

2. *Universiteti Ismail Qemali:*

- a. Universiteti "Ismail Qemali" angazhohet në ofrimin e mjediseve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Marin Barletit;
- b. Universiteti "Ismail Qemali" angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, uorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- c. Universiteti "Ismail Qemali" angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
- d. Universiteti "Ismail Qemali" angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojnë kontribut Marin Barleti, me kërkesën e tij.



SHKOLLË "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"



e. Personi i kontaktit do të jetë: Z/Znj _____

3. *Palët bashkarisht bien dakort si vijon:*

a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese, të shprehur në një dokument të shkruar.

2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj.

3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Marin Barleti dhe 2 (dy) Universiteti "Ismail Qemali".

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

SHKOLLË "Universiteti Marin Barleti"

Rektori

Prof. Dr. Marenglen Spiro



Universiteti "Ismail Qemali"

Rektori

Prof. Roland Zisi

